





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçlanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçlan
Gilan Beledijesi

Në mbështetje të nenit 46 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës së Gjiçlanit , 01.Nr.016-126211 të datës 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet 01. 016-28448 të datës 22.03.2018, nenin 11 të Rregullores për punën e Kuvendit të Komunës së Gjiçlanit 01.nr.16-53246 të datës 13.06.2013, Kuvendi i Komunës së Gjiçlanit në mbledhjen e mbajtur me 30.11.2023, merr:

V E N D I M


PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 2024

1. Me këtë vendim themelohet Grupi punues për hartimin e Planit vjetor të punës për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës së Gjiçlanit.

Grupi punues ka këtë përbërje:

- 1.1 Kushtrim Kadriu, Kryesues
 - 1.2 Ismajl Kurteshi, anëtarë (LVV)
 - 1.3 Ardhmërie J. Musliu, anëtare (LVV)
 - 1.4 Avdyl Aliu, anëtarë, (LDK)
 - 1.5 Gentrit Murseli, anëtarë, (LDK)
 - 1.6 Drenushë Maloku, anëtare, (LDK)
 - 1.7 Gresa Avdiu, anëtare, (LDK)
 - 1.8 Suzana Selimi, anëtare, (PDK)
 - 1.9 Nazim Gagica, anëtarë, (AAK)
2. Grupi punues si në pikën 1 të këtij vendimi, në konsultim me kryetarin e Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, subjektet politike të përfaqësuar në Kuvend dhe shoqërinë civile, harton Draftin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Gjiçlanit për vitin kalendarik 2024 dhe të njëjtin e paraqet para Kuvendit të Komunës për miratim.
 3. Plani vjetor i punës së Kuvendit duhet të përmbajë: objektivat dhe qëllimet e kuvendit, aktivitetet e planifikuara të Kuvendit dhe Komiteteve obligative dhe funksionale të Kuvendit, afatet e përmbushjes dhe realizimin e aktiviteteve të parapara si dhe koston financiare për implementimin e Planit të punës.
 4. Plani i punës së Kuvendit mund të ndryshohet dhe plotësohet nga ana e Kuvendit sa herë që kjo të jetë e nevojshme.
 5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i KK-Gjiçlan.
 6. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në web faqen e Komunës.

01.Nr.016-128695
Gjiçlan, më 30.11.2023



Kryesuesi i Kuvendit,
Kushtrim Kadriu/